

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	213 lekë për litër, çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar arrin nivelin më të lartë historik
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/213-leke-per-liter-cmimi-i-naftes-ne-mbreterine-e-bashkuar-arrin-nivelin-me-i588954
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:50:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0034bb4c7e876e2fec4de000f8bdb15c334aa4606d1c7496405e76ed5d09efdf
TEKSTI	f532f09a3886cdd5204540d1fc675ecba33ab1b49f8aac9c371f8df69ead45ac
PAMJA	52cc414150601cb492f8a062de14ff69d5415d1809a1127af2a667fb9e8b8fd7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1b7cda85dd064cc2e6958b3a9fe657855af215f3e617cf0764c30a8424ff4d73
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1b7cda85dd064cc2e6958b3a9fe657855af215f3e617cf0764c30a8424ff4d73>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie [Alarm per WhatsApp-in - AKSK paralajmëron për kompromentim illogarish dhe apelon për kujdes të shtuarish-presidenti francez rikthehet në skenën politike: Të bashkëfundit](#)

213 lekë për litër, çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar arrin nivelin më të lartë historik



28 Shtator 2026, 15:50 Bota TEMA



Çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar ka arritur një rekord historik prej 1,9918 paund për litër (213 lekë për litër), sipas organizatës automobilistike RAC, ndërsa lufta në Lindjen e Mesme vijon të rrisë koston e karburanteve. Edhe çmimi i benzinës vijon të rritet, me një litër që aktualisht kushton 1,74 paund.

Gjatë shtatë muajve të fundit, lufta mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara ka shkaktuar ndërprerje të mëdha në prodhimin dhe transportin e naftës në rajon, duke çuar në rritje të ndjeshme të çmimeve të karburanteve të prodhuara nga nafta. RAC tha se çmimi i naftës ka hyrë në "territor të paeksploruar", duke shërbyer si një kujtesë për "varësinë e madhe të Britanisë së Madhe nga ngjarjet që ndodhin shumë larg saj".

Çmimi i naftës është rritur tashmë me gati 40% që nga shpërthimi i konfliktit mes SHBA-së dhe Iranit në fund të shkurtit. Rekordi i mëparshëm ishte 1,9909 paund për litër, i regjistruar në qershor 2022.

Rritja do të thotë se mbushja e një automjeti familjar mesatar me naftë kushton tashmë rreth 110 paund, ose 31 paund më shumë se në fillim të konfliktit.

Benzina kushton aktualisht 0,41 paund për litër më shumë se në fillim të konfliktit, por çmimi i saj mbetet ende ndjeshëm nën rekordin e vitit 2022.

Të dhënat e RAC bazohen në çmimin mesatar të naftës në një sërë supermarketesh, pikash karburanti në autostrada dhe shitësish të pavarur.

Edhe Rusia, një tjetër prodhues i madh i naftës, ka vendosur një ndalim të eksporteve të naftës, pas sulmeve të Ukrainës ndaj rafinerive të saj, duke kufizuar më tej furnizimin.

Nafta është më e vështirë për t'u rafinuar se benzina dhe, për shkak se përdoret gjerësisht nga industria e transportit të mallrave dhe në bujqësi, është shumë e vështirë të reduktohet kërkesa për të.

Mbretëria e Bashkuar është shumë e varur nga importet. Edhe pse katër rafineritë në vend prodhojnë më shumë benzinë sesa nevojitet për konsum, ato nuk prodhojnë mjaftueshëm naftë për të përmbushur nevojat e vendit.

Sipas të dhënave të Departamentit për Transportin, në fund të qershorit, në rrugët e Mbretërisë së Bashkuar qarkullonin 15,1 milionë automjete me naftë. Kjo shifër është më e ulët se një vit më parë, kur ishin 15,7 milionë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ish-presidenti francez rikthehet në skenën politike: Të bashkohemi për të mundur Le Pen](#)

14:40 Bota

Ministri izraelit, komandantit të Hamasit: Do të të ekzekutoj

13:10 Bota / 1 koment

["Diplomacia e pandave" rikthehet në SHBA!](#)

11:10 Bota

Çfarë dimë për hetimin kundër terrorizmit në bazën amerikane në Britani

10:50 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.